



fq. 2 Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi, raporton në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë

VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për Periudhën Janar-Mars 2015 fq. 3
- » Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për Periudhën Janar-Mars 2015 fq. 4

ZHVILLIME TË TJERA

- » Workshop me Temë “Mbikëqyrja dhe rregullimi i tregjeve të letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve në Shqipëri” fq. 6
- » Takime të Këshillit dhe Komitetit të Shoqatës Ndërkombëtare Aktuariale (IAA) fq. 7
- » Forum Ndërkombëtar për Sigurimet, “Sigurimi motorik-rruga drejt përfitimit” fq. 8
- » Konferenca Ndërkombëtare për Teknologjinë e Informacionit në Financë dhe Biznes fq. 9
- » Seminar mbi Zhvillimin e Standardeve Ndërkombëtare në Sigurime fq. 10

LAJMET NGA RAJONI

- » Gjeorgji fq. 11
- » Moldavi fq. 11
- » Serbi fq. 12

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi, raporton në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë



*Znj. Enkeleda Shehi, në Komisionin për Ekonominë
dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë*

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi, paraqiti më 27 prill 2015, në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, të Kuvendit të Shqipërisë, raportin mbi aktivitetin e institucionit dhe zhvillimet e tregjeve financiare që mbikëqyren nga AMF gjatë vitit 2014.

Në fjalën e saj, Znj. Shehi u përqendrua në drejtimet kryesore të nxitjes e zhvillimit të tregjeve të sigurimeve, letrave me vlerë, fondeve të investimeve dhe fondeve të pensioneve private vullnetare, si tregje financiare që mbikëqyren nga AMF. Në raportim u evidentuan prirja për zgjerim që këto tregje kanë pasur edhe gjatë vitit 2014, si dhe masat e marra nga AMF për administrimin e rreziqeve dhe stabilizimin e tregjeve.

Fjalën e plotë, mbajtur nga Znj. Enkeleda Shehi në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Shqipërisë, e lexoni në linkun poshtëshënuar.

<http://www.amf.gov.al/files/File/Veprimtaria%20e%20AMF%20viti%202014.pdf>

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-mars 2015

Tregu i sigurimeve u rrit me 14.41% gjatë periudhës janar-mars 2015. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 3.02 miliardë lekë. Kjo u shoqërua me rritje të numrit të policave të sigurimit me 10.08% duke arritur në 225,337 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 18.61% në krahasim me periudhën janar-mars 2014. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 0.48 miliardë lekë, apo 67.57% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 18.44% gjatë periudhës janar-mars 2015, krahasuar kjo me periudhën janar-mars 2014.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 1.79 miliardë lekë gjatë periudhës janar-mars 2015, duke shënuar një rritje prej 34.75% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës janar-mars 2015 përbënte 59.29% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- » zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 17.87% të tregut të Jo-Jetës;
- » sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme të cilat së bashku zunë 12.44% të tregut të Jo-Jetës.

Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 14.83% krahasuar me periudhën janar-mars të vitit 2014. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila zinte 63.72% të sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-mars 2015

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.




Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2015

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2015 përbëhej nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) në masën 55.55% dhe pjesa tjetër prej 44.45% ishin transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 71.52% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2015 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 69.32% dhe 17.62% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 95.93% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Letra me Vlerë të Qeverisë, janar-mars 2015



- A. Blerje në tregun primar
- B. Shitje nga portofoli i ndërmjësit financiar
- C. Blerje para afatit të maturimit
- D. Vendosje e bonos si kolateral
- E. Shlyerje e vlerës nominale në maturim

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “**Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar**” gjatë periudhës janar-mars 2015, ka pasur një ulje prej 369 milionë lekë, ose 23.11% krahasuar me janar-mars 2014. Po kështu është ulur edhe numri i transaksioneve, në masën 36.17%.

Transaksioni i llojit C “**Blerje para afatit të maturimit**” gjatë periudhës janar-mars 2015 ka pasur një rritje prej 194 milionë lekë, ose 37.85% krahasuar me janar-mars 2014. Kjo është shoqëruar edhe nga rritja e numrit të transaksioneve, në masën 14.15%.

Krahasuar me janar-mars 2014, vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 175 milionë lekë.

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

| Lloji i Transaksionit | | Vlera nominale | | Ndryshimi |
|-----------------------|---|----------------|----------|-----------|
| | | (Në mln. lekë) | | (Në %) |
| Periudha janar-mars | | 2014 | 2015 | '15/'14-1 |
| B | Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar | 1,597.80 | 1,228.55 | (23.11) |
| | Individë | 1,480.45 | 931.51 | (37.08) |
| | Persona juridike | 117.35 | 297.04 | 153.13 |
| C | Blerje para afatit të maturimit | 511.88 | 705.64 | 37.85 |
| | Individë | 404.02 | 646.14 | 59.93 |
| | Persona juridike | 107.86 | 59.50 | (44.84) |

ZHVILLIME TË TJERA

Workshop me temë “Mbikëqyrja dhe rregullimi i tregjeve të letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve në Shqipëri”



Gjatë zhvillimit të workshopit me temë “Mbikëqyrja dhe rregullimi i tregjeve të letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve në Shqipëri”

Në datën 8 prill 2015 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi në Tiranë *workshopin* “Mbikëqyrja dhe rregullimi i tregjeve të letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve në Shqipëri” me përfaqësues nga Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursës së Maqedonisë. Ekipi nga Maqedonia kryesohej nga Znj. Elizabeta Chingarovska, Presidente e këtij institucioni.

Duke përshëndetur *workshopin*, Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi, bëri një përshkrim të shkurtër të tregjeve që AMF mbikëqyr dhe peshës që ato zënë në tregun financiar të vendit. Duke u ndalur më specifikisht tek fondet e investimeve, Znj. Shehi nënvizoi zgjerimin e madh që fondet e investimeve kanë marrë në Shqipëri në një periudhë të shkurtër që nga viti 2012 kur filloi aktivitetin i pari fond i investimeve në vend.

Gjatë *workshopit*, ekspertë të AMF-së prezantuan ecurinë dhe zhvillimet në tregun e letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve në Shqipëri. Përmes shifrave u prezantua ecuria e fondeve të investimeve, totali i asetëve të cilave në fund të vitit 2014 zinte 4.7% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), me një rritje të madhe krahasuar me vitin 2012 kur fondet e investimeve filluan për herë të parë aktivitetin dhe asetet e tyre zinin vetëm 1.2% në totalin e PBB.

Gjatë *workshopit*, ekspertë të AMF-së prezantuan rëndësinë që ka tregu i kapitaleve në ekonominë shqiptare nëpërmjet rritjes në mënyrë më të shpejtë të investimeve të brendshme, përmirësimit të alokimit të fondeve e cila çon në një rritje më të shpejtë ekonomike të vendit, diversifikimit të mundësive për investime dhe likuiditete, përmirësimit të disiplinës kooperative dhe mirëqeverisjes. Ndër çështjet e tjera që u trajtuan lidhur me zhvillimin e tregut të kapitaleve ishin:

- » Kuadri i plotë ligjor që rregullon dhe mbikëqyr tregun e letrave me vlerë dhe фондеве të investimeve;
- » Infrastruktura këtij tregu dhe roli i AMF-së në mbikëqyrjen dhe rregullimin e tij;
- » Platforma elektronike *online* e AMF-së për tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë;
- » Ecuria e Shqipërisë në procesin e Stabilizim-Asociimit për tregjet financiare nën mbikëqyrjes e AMF-së;
- » Direktivat evropiane që rregullojnë tregun e kapitaleve, sfidat e përpjekjet e Shqipërisë për zbatimin e tyre;
- » Rëndësia e zhvillimit të Bursës së Tiranës;
- » Zhvillimet e fundit në drejtim të rritjes së pavarësisë së Autoritetit dhe forcimit të rolit të tij në tregjet financiare.

Një këndvështrim të ndryshëm solli edhe prezantimi i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të “Raiffeisen Invest” Z. Resmi Hibraj, i cili prezantoi ecurinë në vite të dy фондеве, Fondit të Investimeve “Raiffeisen Prestigj” dhe Fondit të Investimeve “Raiffeisen Invest Euro” të cilët kanë arritur rreth 33 mijë anëtarë.

Gjatë *workshopit* u këmbyen mendime edhe për zhvillime për të cilat vendet mund të shkëmbejnë eksperiencë siç është rasti i Bursës së Maqedonisë, e cila është ngritur që në vitin 1996 dhe ka të listuar rreth 150 kompani.

AMF dhe Komisioni i Letrave me Vlerë i Bursës së Maqedonisë kanë që prej vitit 2005 një marrëveshje bashkëpunimi e cila u shërben të dy institucioneve. Si Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Znj. Shehi, ashtu edhe Presidentja e Komisionit të Letrave me Vlerë dhe Bursës së Maqedonisë, Znj. Chingarovska e vlerësuan këtë vizitë dhe *workshopin* mjaft të rëndësishëm në thellimin e bashkëpunimit dhe forcimin e marrëdhënieve midis dy institucioneve.

Takime të Këshillit dhe Komitetit të Shoqatës Ndërkombëtare Aktuariale (IAA)

Shoqata Ndërkombëtare Aktuariale (IAA) zhvilloi në datat 07-11 prill 2015, në Zyrin, disa takime të Këshillit dhe Komiteteve të shoqatës ku u trajtuan tema të ndryshme. Shqipëria është anëtare e asociuar e Shoqatës Ndërkombëtare Aktuariale dhe u ftua të ishte pjesëmarrëse në disa prej këtyre takimeve, që lidheshin me Komitetin e Standardeve Aktuariale, si edhe me Komitetin e Edukimit dhe Programit Mësimor.

Disa nga çështjet e trajtuara në këto takime ishin:

- » Ndryshimet në standardin e formave aktuariale të raportimeve si: ISAP 3, ISAP 4, ISAP 5 & 6 dhe ISAP 7 lidhur me modelet mbi zhvillimin e menaxhimit të rrezikut, si dhe çështje të tjera lidhur me standardet e kapitalit të IAIS;
- » Programi mësimor standard mbi edukimin aktuarial, i cili duhet të aplikohet si program bazë në të gjitha shoqatat dhe institucionet arsimore, pjesë e shoqatës ndërkombëtare aktuariale, që ofrojnë mësimdhënie në lëndët aktuariale.

Takimet patën diskutime për pika të veçanta që lidheshin me ecurinë më tej dhe zbatimin e këtyre ndryshimeve dhe programeve mësimore në praktikën e punës aktuariale.

Në këto takime merrnin pjesë përfaqësues nga shoqatat e asociuara aktuariale nga vende të tilla si: Afrikë e Jugut, Armeni, Australi, Austri, Azerbajxhan, Brazil, Britani e Madhe, Danimarkë, Francë, Gjermani, Iran, Itali, Izrael, Japoni, Kanada, Luksemburg, Marok, Norvegji, Spanjë, Suedi, SHBA, Turqi, Zvicër, etj.

Forum Ndërkombëtar për Sigurimet, “Sigurimi motorik-rruga drejt përfitimit”

Grupi XPRIMM Media zhvilloi më 19-20 prill në Stamboll, Turqi, Forumin Ndërkombëtar mbi Sigurimet. Ky forum është i përvitshëm dhe tema e tij për këtë vit ishte “Sigurimi Motorik-rruga drejt përfitimit”.

Folësi kryesor që iu drejtua forumit ishte z. Mariusz Wichtowski, President i Këshillit të Byrove (Council of Bureau, CoB). Profesionistë të shquar nga fusha e sigurimit motorik nga 16 vende të botës ishin gjithashtu folës në këtë forum. Sesioni i parë i konferencës ju dedikua efektivitetit në biznesin e sigurimit motorik. Më pas konferenca vazhdoi në dy seksione teknike që diskutuan çështje specifike. Krahas pasqyrimit të ecurisë së sigurimit motorik në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, si dhe në vendet e Kaukazit, diskutimet në forum u fokusuan në:

- » Dilemat e çmimit, i shtrenjtë, por i përballueshëm;
- » Kostot e kontrolluara, përmirësimi i raportit të kombinuar;
- » Shpërndarja e sigurimit motorik, cilësia dhe teknologjia në sigurimin motorik si kusht për të pasur fitime;
- » Mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe promovimi i politikave më të mira të çmimeve, etj.

Në forum u prezantua edhe botimi i ri “Sigurimi Motorik XPRIMM” i cili prezanton aspekte të ndryshme të sigurimit motorik, analizat e tregut dhe statistikatat për vendet e rajonit, infrastrukturën, shpeshhtësinë dhe shkaqet kryesore të aksidenteve rrugore. Botimi paraqet edhe të dhëna për volumin e primeve të shkruara bruto, dëmeve të paguara dhe çështjeve specifike për secilin vend.

Konferenca Ndërkombëtare për Teknologjinë e Informacionit në Financë dhe Biznes

Më 23 prill 2015 në Sofje, Bullgari, u zhvillua Konferenca Ndërkombëtare “Teknologjia e informacionit në financë dhe biznes”. Kjo konferencë u organizua nga Shoqata e Sistemit të Informacionit dhe Auditimit, ISACA në bashkëpunim me ICT Media, dhe me mbështetjen e Shoqatës së Bankave, Shoqatës së Kompanive të Sigurimit dhe Shoqatës së Pensioneve Suplementare të Bullgarisë. Ekspertë të teknologjisë së informacionit ndanë eksperiencat e tyre duke theksuar rëndësinë e burimeve të informacionit dhe zhvillimin e projekteve të duhura për rritjen ekonomike të biznesit dhe monitorimin e rregullimin e tij. Diskutimet u përqendruan në fushën e analizës së të dhënave informatike, nëpërmjet të cilave mund të nxirren informacione të caktuara të zhvillimit ekonomik ose sjelljes së konsumatorit dhe tregut, të cilat orientojnë biznesin drejt suksesit.

Gjatë konferencës u bënë prezantime nga studiues dhe ekspertë të ndryshëm si:

- » Dixhitalizimi dhe analiza e të dhënave;
- » Menaxhimi i suksesshëm i kartave;
- » Të shkosh përtej transaksionit;
- » Ndërtimi i platformave me disa kanale;
- » Qendërimi i klientëve dhe menaxhimi i të dhënave;
- » Mundësitë dhe sfidat e pagesave dixhitale;
- » Gara për eficientë;
- » Projekti e-Agjenti – projekt që lidhet me optimizmin e aktivitetit të agjentëve të sigurimit.

Kjo konferencë, e organizuar nga ISACA në bashkëpunim me ICT Media, është një aktivitet i përvitshëm, me tematika të ndryshme të lidhura me teknologjinë e informacionit.

Seminar mbi Zhvillimin e Standardeve Ndërkombëtare në Sigurime

Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI) në bashkëpunim me Shoqatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime zhvilluan në, Bazel, Zvicër seminarin “Mbi zhvillimin e standardeve ndërkombëtare në sigurime mbi aftësinë pagueuse, si dhe kërkesat mbi kapitalet e veta për siguruesit me zbatim ndërkombëtar”. Në të morën pjesë mbikëqyrës nga 25 vende të ndryshme të botës.

Ndër temat kryesore që u trajtuan gjatë seminarit ishin:

- » Vlerësimi i provigjoneve teknike;
- » Kërkesat e kapitalit, metodat standarde, si dhe modelet e brendshme;
- » Perspektiva aktuariale e menaxhimit të riskut dhe të kapitalit;
- » Implementimi i *Solvency 2*, lidhja ndërmjet kërkesave sasiore dhe cilësore;
- » Vlerësimi me anë të modeleve të brendshme i mjaftueshmërisë së kapitalit, rasti i *Swiss Re*.

Gjatë seminarit, përfaqësues të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare bënë prezantimin e tematikave dhe më pas u diskutua për eksperiencat e problematikat e ndeshura në zbatimin e këtyre temave nga vende të ndryshme.

LAJMET NGA RAJONI

GJEOGJJI

www.xprimm.com

Siguruesit gjeorgjianë u përballën me një vit sfidues në 2014, kryesisht për shkak të ndërprerjes së programit për sigurimin e shëndetit. Me iniciativën e Qeverisë së Gjeorgjisë, në vitin 2007, u krijua programi shtetëror për sigurimin e shëndetit për t'u ofruar sigurim mjekësor grupeve të pambrojtura e të dobëta të popullsisë gjeorgjiane nëpërmjet kompanive private të sigurimit. Vlera e primeve të shkruara bruto për këto produkte shënoi afërsisht 45% të totalit të primeve të shkruara bruto në vitin 2013. Në vitin 2014 programi u anulua. Si rezultat i kësaj, pavarësisht rritjes së madhe në produktet e tjera, tregu i sigurimeve u zvogëlua me rreth 30% të totalit të primeve të shkruara bruto.

Primet e shkruara bruto nga siguruesit gjeorgjianë në vitin 2014 arritën vlerën 133.6 milionë euro, afërsisht 32.3% më pak nga viti i kaluar. Arsyeja kryesore e kësaj rënieje ishte heqja e plotë e kompanive të sigurimit, duke filluar që prej datës 1 prill 2014, nga të gjitha projektet e qeverisë, siç ishte programi universal i kujdesit për shëndetin.

Sigurimi i Jetës dyfishoi përqindjen e tij në portofolin e tregut, megjithatë ai vazhdon të mbetet një pjesë shumë e vogël e tregut dhe është ende në fillimet e zhvillimit të tij.

Në sigurimin e Jo-Jetës volumi i primeve të shkruara bruto, megjithëse shënoi rritje të madhe në thuajse të gjitha produktet, vazhdon të jetë më i ulët krahasuar me tregjet tjera të rajonit. Nga 900,000 automjete të regjistruara zyrtarisht, vetëm rreth 7% janë të siguruar me sigurim Kasko të mjeteve motorike dhe rreth 6% janë të siguruar me sigurim MTPL. Përmendim këtu se sigurimi MTPL në Gjeorgji nuk është ende i detyrueshëm.

Në lidhje me perspektivat për vitin 2015, ligji për sigurimin e detyrueshëm MPTL vazhdon të jetë pjesë e rendit të ditës në Gjeorgji.

MOLDAVI

www.xprimm.com

Sipas statistikave zyrtare të Komisionit Kombëtar të Tregut Financiar (*National Commission of Financial Market – NCFM*) në tregun moldav të sigurimeve primet e shkruara bruto në vitin 2014 u rritën rreth 0.4% më shumë sesa viti i kaluar duke arritur në 1.2 miliardë MDL (Leu Moldav). Për shkak të zhvlerësimit të monedhës vendase në raport me euron, tregu i sigurimeve shënoi një normë ulje me rreth 9.9%, në afërsisht 64.6 milionë euro. Vlera e dëmeve të paguara bruto nga siguruesit u rrit me 6.6% në krahasim me vitin e kaluar dhe arriti afërsisht në vlerën 27.6 milionë euro, nga të cilat kategoritë e sigurimit të mjeteve motorike, sigurimi Kasko, MTPL dhe Kartoni Jeshil, të marra së bashku zinin, më shumë se 58%, ose afërsisht 16 milionë euro.

Volumi i primeve të shkruar bruto u dominua nga kategoritë e sigurimit për mjetet motorike MTPL, sigurimi Kasko, Kartoni Jeshil, të cilat kanë gjeneruar së bashku thuajse 64% të totalit të primeve. Në të njëjtën kohë, dy linjat e sigurimit të pronës (zjarri, dëme të lidhura me të dhe dëme të tjera që lidhen me sigurimin e pronës) zunë përreth 12% të totalit të primeve të shkruara bruto. Sigurimi i Jetës në vitin 2014 krahasuar me vitin e kaluar u rrit me 6.7% duke arritur vlerën e 4.3 milionë euro.

Sipas të dhënave të publikuara volumi i primeve të shkruara bruto në vitin 2014 në tregun serb të sigurimeve shënoi një rritje prej 8.4% duke arritur në 69.4 miliardë RDS (Dinari). E shprehur në monedhën evropiane, duke pasur parasysh zhvlerësimin prej 6% të Dinarit Serb, rritja e tregut ishte vetëm 2.7% duke arritur vlerën 573.8 milionë euro.

Sigurimi i Jetës, i cili zë afërsisht 23% të tregut, regjistroi një normë rritjeje prej 7.85% të primeve të shkruara bruto. Dëmet e paguara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me afro 18%.

Në sigurimin e Jo-Jetës vlera e primeve të shkruara bruto u rrit me 1.3% e shprehur në monedhën euro. Ndërmjet klasave të ndryshme të Jo-Jetës, ekzistojnë ndryshime të konsiderueshme, ku kategoria MTPL ka pasur rezultatet më të mira, me një normë rritje, në vitin 2014, të vlerës së primeve të shkruara bruto rreth 9.95% dhe një ulje prej 14% të dëmeve të paguara.

Sikurse njofton Banka Kombëtare e Serbisë, produkti MTPL është ende segmenti dominues i tregut serb të sigurimeve, i cili përbënte 32.7% të primeve në total në vitin 2014 dhe kishte më shumë se 2 milionë të siguruar. Rritja e primeve të shkruara bruto në sigurimin MTPL pati një ndikim të madh në të gjithë portofolin e sigurimit të Jo-Jetës, në mënyrë të veçantë, duke pasur parasysh rritjen e ulët të regjistruar nga linjat e tjera Jo-Jetës, të cilat nuk janë sigurime të detyrueshme.

Në vitin 2014, ngjarjet më të rëndësishme që lidhen me sigurimet në Serbi ishin përmbytjet dramatike gjatë stinës së verës. Ato patën ndikim në bilancin e siguruesve deri në një shkallë të caktuar, por sigurisht, prekën në përmasa dramatike popullsinë dhe shumë biznese. Për shkak të mbulimit të pakët me sigurime, shumë pak nga humbjet totale u mbuluan nga sektori i sigurimeve.

Sigurimi i pronës është segmenti i dytë më i rëndësishëm në tregun serb të sigurimeve të Jo-Jetës, duke zënë më shumë se një të pestën e primeve në total gjatë vitit 2014. Sigurimi i pronës ka regjistruar norma modeste rritjeje për vite me radhë dhe kjo tendencë vazhdoi edhe në vitin 2014, ku primet e sigurimit të pronës, shënuan një normë rritje prej 2.2% në krahasim me vitin e kaluar (e shprehur në monedhën lokale RSD). Rëndësia e sigurimit të pronës u theksua në Serbi pas ndikimeve të përmbytjeve shkatërruese të muajit maj. Humbjet ekonomike në total për shkak të këtyre përmbytjeve u llogaritën në një shifër tronditëse prej 1.5 miliardë euro, e cila përfaqëson 4.5% të Produktit të Brendshëm Bruto të Serbisë. Depërtimi i ulët i sigurimeve u shpreh në vlerën e humbjeve të siguruara, që ishin më pak sesa 40 milionë euro.